



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 14/2009  
Më 28. 04. 2009, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj, Mufëra Şinik dhe Zef Morina. Mungoi: deputeti Slobodan Petroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Ilir Imeri, Magbule Shkodra dhe Vjollca Limani - ART, Krenare Sfishta dhe Novitet Kryeziu – MEM, Valon Stavileci – MEM – PATEL, Haxhi Gashi – USAID, Lumnije Murati – Zyra e Presidentit, Blerina Uka – NDI, Ramadan Klisurica – KDI dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 21. 04. 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të ART-së për vitin 2008;
4. Verifikimi i saktësisë së Raportit të amendamentimit të P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për gazin natyror;
6. Të ndryshme.

## **I. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pasi u hoq pika III, sepse nuk merrnin pjesë anëtarët e Bordit të Autoritetit të Rregullatorit të Telekomunikacionit - ART.

## **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 21. 04. 2009**

Procesverbali i mbledhjes së datës 21. 04. 2009 u miratua pa vërejtje.

## **III. Verifikimi i saktësisë së Raportit të amendamentimit të P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë**

**Kryetarja** – Ua përkujtoi të pranishmëve se amendamenti i P/ligjit ka përfunduar në mbledhjen e kaluar. Tani do ta bëjmë verifikimin e saktësisë së Raportit me amendamente të miratuara. Ia dha fjalën z. Shatri, raportues për Projektligjin.

**Haki Shatri** – Vlerësoi se stafi Mbështetës e ka hartuar raportin me amendamentet e miratuara duke i përfshirë të gjitha vërejtjet miratuara në Komision. Vlerësoi se mund ta miratojmë pa asnjë vërejtje.

**Safete Hadërgjonaj** – Paraqiti vërejtjet në parim për amendamentimin e P/ligjit dhe tha se është krijuar një monopol kompetencash për ministrin në sektorin e naftës. Në veçanti u përqendrua në amendamentin 8, që ka të bëjë me Komisionin e Ankesave, me përbërjen, me strukturën dhe me përgjegjësinë. Shprehu pakënaqësi për mënyrën e punës paraprake të grupit të punës. Sipas saj shqyrtimi paraprak duhet të bëhet në grupin e punës, por kurrsesi vetëm nga raportuesi.

**Sala Berisha – Shala** – Propozoi t'i jepej fjala konsulentit të Komisionit, sepse mund ta shfrytëzojmë përvojën e tij të ish-sekretarit permanent të MTI-së.

**Berim Ramosaj** – Duke replikuar me znj. Berisha – Shala, tha se nuk është koha që konsulenti të japë vërejtje, sepse amendamenti ka përfunduar. Tani jemi duke e vlerësuar ndonjë lëshim të administratës dhe jo amendamentimin. Pra Raporti është në fazën përfundimtare. Në vazhdim konstatoi se amendamentet, së bashku me vërejtjet e miratuara në mbledhjen e fundit, janë përfshirë dhe inkorporuar me saktësi në Raport. Propozoj të mos kthehemi në fillim të rishqyrtimit të Projektligjit, por ta miratojmë Raportin, nëse nuk ka ndonjë lëshim nga administrata.

**Safete Hadërgjonaj** – Propozoi që ky projektligj, bashkë me Raportin, t'i jepet konsulentit për shqyrtim dhe të caktohet një mbledhje tjetër, në të cilën do të shqyrtohej dhe do të miratohej Raporti.

**Haki Shatri** – Theksoi se grupi i punës është marrë me këtë projektligj gjerë e gjatë. Pothuajse 4 (katër) javë është duke u diskutuar për të në Komision. Komisioni i ka miratuar të gjitha amendamentet që janë përfshirë në Raport. Propozoi të mos hapet debat

përsëri, por të miratohet Raporti nëse nuk ka lëshime.

**Ethem Çeku** – Tha se kemi punuar në atë frymë që ky projektligj të jetë sa më profesional dhe funksional. Kemi kërkuar që edhe Këshilli për Licenca të jetë trup profesional dhe të emërtohet: Zyra për Licenca. Kemi vendosur që anëtarët e saj të jenë shërbyes civilë. Po ashtu kemi vendosur që Komisioni për Ankesa të jetë i përbërë edhe nga zyrtarë të tjerë, jashtë strukturës së MTI-së, sikur që është caktuar edhe nga biznesi i sektorit të naftës. Në këtë rast sipas tij këtu është vetëm një dilemë: sa anëtarë duhet t'i ketë ky komision? Nuk ishte i mendimit të shtyhet më tutje ky raport, por të miratohet sot.

**Zef Morina** – Theksoi se çdo vendim do të ishte mirë të merrej me konsensus në Komision. Nëse nuk arrihet kjo, atëherë të vendoset me shumicë votash. Kërkoj që sot të eliminohen këto paqartësi ose dilema dhe propozoi që Komisioni t'i ketë 5 (pesë) anëtarë.

**Haki Shatri** – U pajtua të bëhen ndryshime në amendamentin 8 lidhur me nenin 11, pika 1, që në vend të 3 (tre), të bëhet 5 (pesë) anëtarë dhe të ndryshohet pika 2, e nenit 11, si dhe të shtohen përfaqësuesit e MEM-it dhe të MEF-it.

**Fatmir Rexhepi** – U pajtua me ndryshimet e bëra. Ishte i mendimit të miratohej Raporti përfundimtar.

**Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit** – Theksoi se me këtë ndryshim eliminohet monopoli i vendimmarrjes dhe fuqizohet Komisioni i Ankesave, që në një formë e mbikëqyr punën e Këshillit. Propozoi përbërjen e tij, si vijon: nga një anëtar të MTI-së, të MEM-it, të MEF-it, dhe të komuniteti të biznesit, si dhe një anëtar nga Komisioni i Konkurrencës. Me këtë rast puna e tij e raportimit do të rregullohej me një udhëzim administrativ, që do të nxirrej në nivel ndërqeveritar.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Përfundim**

- I. Miratohet raporti për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë, me vërejtjet e paraqitura.
- II. Njësia Mbështetëse e Komisionit t'i spastrojë dhe t'i sistemojë të gjitha propozimet e miratuara.

### **IV. Shqyrtimi i Projektligjit për gazin natyror**

**Ethem Çeku** – I propozoi anëtarët e grupit të punës për Projektligjin për gazin natyror: Fatmir Rexhepin - kryesues, Berim Ramosajn dhe Sala Berisha – Shalën.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

## Përfundim

- I. Grupi i punës i Projektligjit për gazin natyror ta ketë këtë përbërje: Fatmir Rexhepi - kryesues, Ethem Çeku, Berim Ramosaj dhe Sala Berisha – Shala.

### V. Të ndryshme Çështje vijuese

**Kryetarja** – Kërkoj që në mbledhjen e radhës të ftohet Ministria e Transportit dhe e Post-Telekomunikacionit për të trajtuar temën: Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për rrugët.

**Zef Morina** - kryesues i grupit punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për rrugë dha dorëheqje nga pozita e kryesuesit, nga se është krijuar përshtypje në opinion se ka konflikt interesi.

#### **Dorëheqja u miratua pa diskutime.**

**Kryetarja** - kërkoj të ftohet edhe një herë një përfaqësues i Bordit të ART-së për shqyrtim të Raportit një vjeçar 2008.

**Ethem Çeku** – Kërkoj që në mbledhjen e radhës të ftohet Ministria e Energjisë dhe e Minierave për diskutim për pakon e projektit “Kosova e Re”.

#### **Propozimet u miratuan.**

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30.

Kryetare e Komisionit

---

Myzejene Selmani